



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0168

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori -Anëtar të Paenlit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE Beni Dona Plast SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 05/05/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserishte ankesa e Beni Dona Plast SH.P.K. me nr. 2026/0168, e datës 19/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se”, me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – POLICIA E KOSOVËS.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se”, me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1.
3. I shqiptohet, vërejtje Autoritetit Kontraktues për shkak të prolongimit të këtij aktivitetit të prokurimit me procedurë të hapur, dhe gjetjeve sipas këtij vendimi.
3. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohen si pjeserisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.09.2025 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se” me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,700,000.00 €.

Me 27.02.2026 POLICIA E KOSOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin për kontratë (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 04.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 09.03.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.03.2026, OE " Beni Dona Plast SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0168, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit të aktivitetit për dhenie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ Beni Dona Plast SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, pas ri-vlerësimit të ofertave në zbatim të Vendimit të PSH nr. OSHP: 2025/1248, të datës 09.02.2026, më datën 27.02.2026 në platformën e E-Prokurimit ka publikuar Formularin B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar, të cilat mbajnë datën 25.02.2026, ndërsa në platformën e E-Prokurimit janë publikuar më datën 27.02.2026.

Në Formularin B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka shënuar: “Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit në mungesë të një oferte të përgjegjshme”.

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë sonë, e cila mban datën 25.02.2026 dhe është publikuar në platformë më datën 27.02.2026, është shënuar, citojmë: “OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim: OE ka ofruar çmime të cilat janë më të larta nga çmimet reale të tregut. Komisioni i rivlerësimit ka kërkuar të bëhet hulumtimi i tregut dhe nga hulumtimi i tregut pas vendimit të OSHP rezulton se OE ka ofertuar me çmime shumë herë më të

larta se ato reale në treg. Duke iu referuar nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e cila përcakton se gjatë administrimit të procedurave të prokurimit Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut, ju keni ofruar çmime shumë herë më të larta se çmimet reale të tregut. Duke iu referuar ofertës financiare, OE ka ofruar çmime shumë herë më të larta për të gjithë artikujt se vlera reale e tregut dhe e planifikuar nga AK. Duke iu referuar edhe interpretimit të KRPP-së, AK në harmoni të plotë me LPP ka kërkuar sqarime gjatë fazës së parë të vlerësimit mbi çmimet shumë herë më të larta se ato reale në treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim, por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri te formimi i këtyre çmimeve.”

Më datën 02.03.2026, përmes platformës së E-Prokurimit – Letrat Standarde, kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentet e tenderit, ndërsa më datën 03.03.2026 kemi pasur qasje në dokumentet e tenderit në lokalet e AK – Policisë së Kosovës. Nga zyrtarët e prokurimit të AK kemi pranuar në CD Raportin e Rivlerësimit të ofertave. Në kërkesën tonë për qasje në dokumente, përveç tjerash, kemi kërkuar edhe qasje në dokumentet që dëshmojnë hulumtimin e çmimeve të tregut të bërë nga zyrtarët e Autoritetit Kontraktues. Zyrtarët e prokurimit na i kanë prezantuar këto dokumente, por nuk na është dhënë asnjë dokument apo dëshmi e këtij hulumtimi.

Të pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.02.2026 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kompania jonë Beni Dona Plast SH.P.K., më datën 04.03.2026, i ka dërguar Policisë së Kosovës kërkesë për rishqyrtim, së bashku me dëshmi të besueshme për çmimet aktuale të tregut për artikujt ushqimorë që përbëjnë “pakot” që AK ka kërkuar të furnizohen.

Më datën 09.03.2026, përmes platformës së E-Prokurimit, kemi pranuar vendimin e AK për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim. Në këtë vendim, si arsye e refuzimit është theksuar se çmimet për njësi të artikujve me të cilat kemi ofertuar janë më të larta, por tani në vend të çmimeve të planifikuara nga hartuesit e specifikave teknike, AK i referohet çmimeve të hulumtimit të tregut të bërë pas vendimit të OSHP-së. Edhe në këtë fazë AK nuk ka ofruar asnjë dëshmi për burimin e këtyre çmimeve, por vetëm ka bashkangjitur një tabelë pa sqaruar në cilat markete apo kompani është bërë hulumtimi.

Nga përbindjet e paraqitura në vendimin për refuzim shihet se ndryshimet janë shumë të vogla, ndërsa në Letrën Standarde është pretenduar se çmimet janë “shumë herë më të larta”. Ky konstatim është joprofesional dhe tendencioz, sepse “shumë herë më i lartë” nënkupton mbi 200% më shumë, gjë që nuk rezulton nga asnjë krahasim.

Pretendimi ynë ankimor bazohet në shkeljen e nenit 59 dhe 62 të LPP-së, si dhe neneve 40, 43 dhe 97 paragrafi (h) të Rregullores 02/2024 për Prokurimin Publik. Konstatimi i AK se ka kërkuar sqarime dhe nuk ka pranuar dokumentim nuk qëndron, pasi zbërthimi i çmimeve kërkohet vetëm për tenderët jo-normalisht të ulët përmes Formularit B41, jo për çmime të konsideruara të larta. Megjithatë, më datën 01.12.2025 kemi dërguar përgjigje dhe kemi zbërthyer të gjitha çmimet dhe elementet që ndikojnë në kosto.

Së bashku me kërkesën për rishqyrtim kemi dorëzuar edhe dëshmi të çmimeve nga ETC, Viva Fresh, Meny – Nazi Restorant, Me Luge dhe kuponë fiskalë, por AK nuk i ka marrë parasysh as në vendimin e parë dhe as në vendimin e fundit për refuzim.

Fakti që çmimet tona janë reale dëshmohet edhe nga ftesa për negociata e datës 15.12.2025 për të njëjtat shërbime, ku kemi ofertuar mesatarisht 2.7% më lirë për disa artikuj dhe me çmime të njëjta për të tjerët. Në procedurën e negociuar kontrata ishte vetëm 3-mujore, ndërsa në procedurën e hapur kontrata ishte 36-mujore, çka justifikon diferencën e vogël për shkak të rrezikut të rritjes së çmimeve.

Çmimet tona janë reale duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të çmimeve të ushqimeve, kostot e transportit, pagat e punëtorëve, rrezikun e rritjes së çmimeve gjatë 36 muajve, vonesat në pagesa deri në 5 muaj, kostot e paketimit mbi 4,000 € në muaj dhe kosto të tjera shtesë. Vetëm pagat e stafit për 36 muaj arrijnë 719,696.50 €, që përbëjnë 26.66% të vlerës së kontratës prej 2,700,000 €.

Në këtë aktivitet kanë ofertuar vetëm dy operatorë ekonomikë. Oferta jonë ka qenë më e lira me çmim të peshuar 65.97 €, ndërsa OE tjetër 68.13 € dhe nuk ka vazhduar validitetin e ofertës.

Bazuar në këto rrethana, AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP duke na diskriminuar, nenit 59 të LPP dhe nenit 40 të Rregullores 02/2024 duke mos marrë parasysh sqarimet dhe provat tona, nenit 62 të LPP dhe nenit 43 të Rregullores duke anuluar aktivitetin pa bazë ligjore, si dhe nenit 97 paragrafi (h) të Rregullores 02/2024 duke mos zbatuar vendimin e Panelit Shqyrtues.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesën tonë ta konsiderojë të bazuar, të urdhërojë Policinë e Kosovës të anulojë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 27.02.2026 dhe lëndën ta kthejë në ri-vlerësim.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigja në pretendimet ankimore të OE " Beni Dona Plast SH.P.K.,

OE "Beni Dona Plast SH.P.K.", Prishtinë, si palë e pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit nga AK për aktivitetin me titull "SHËRBIMET ME USHQIM (FURNIZIM, PËRGATITJE DHE SERVIM) PËR NEVOJAT E PK-SË – E KORRIGJUAR RIVLERËSIM", me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1; 214-25-106-211, pretendon se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, konkretisht:

Neni 7 – Barazia në trajtim / mosdiskriminimi;

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 62 – Përfundimi i aktivitetit të prokurimit.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara të Rregullores 02/2022 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024), OE pretendon shkeljen e:

Neni 40 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 43 – Ndërprerja e procedurave të prokurimit;

Neni 97, paragrafi (h) – Mosrespektimi i vendimit të OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur nenin 7 të LPP-së, pasi të gjithë operatorët ekonomikë janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike. AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure; specifikat teknike janë hartuar në harmoni me LPP dhe nuk përmbajnë kufizime apo favorizime. Ofertat janë trajtuar në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikat teknike, ndërsa oferta e OE ankues është eliminuar për shkak se ka ofruar çmime shumë më të larta se ato reale të tregut; rrjedhimisht, ky pretendim ankimor është i pabazuar.

AK nuk ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të Rregullores për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese, në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit.

Pas vendimit të OSHP-së nr. 2025/1248 të datës 09.02.2026, komisioni i rivlerësimit ka kërkuar nga ZPP që të kryhet hulumtimi i tregut. Kjo kërkesë është adresuar te ZKA, i cili ka themeluar komision për hulumtim të tregut. Komisioni ka dorëzuar raportin mbi hulumtimin e tregut dhe krahasimin e çmimeve reale të tregut me ofertën e OE, duke konstatuar se oferta e OE është rreth 30% më e lartë. Si rezultat, komisioni ka konstatuar se OE ka ofertuar me çmime shumë më të larta se ato reale të tregut. Duke iu referuar nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024 (ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022), AK ka obligim të sigurohet që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut. Për këtë arsye, pretendimi ankimor është i pabazuar.

AK ka kërkuar sqarime për çmime abnormalisht të larta dhe, në pajtim me LPP dhe interpretimin e KRPP-së, vlen e njëjta logjikë si për çmimet abnormalisht të ulëta. Sqarimet e ofruara nga OE ankues nuk përmbajnë arsyetime, fakte apo argumente, por vetëm zbërthim të çmimeve për secilin artikull, pa dëshmi mbi formimin e tyre; rrjedhimisht, pretendimi është i pabazuar.

AK nuk ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores 02/2022, pasi aktiviteti i prokurimit është anuluar në përputhje me pikën (b) të nenit 43 – “asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”. Prandaj, edhe ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi për shkelje të nenit 97 paragrafi (h) nuk qëndron, pasi në përputhje me vendimin e OSHP-së nr. 2025/1248, AK ka anuluar vendimin paraprak, ka formuar komision të rivlerësimit dhe ka vepruar sipas kërkesave të vendimit; rrjedhimisht nuk kemi shkelje të rëndë.

AK ka kërkuar sqarime për çmime më të larta se ato reale të tregut përmes letrës standarde, në përputhje me nenin 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024 dhe interpretimin e KRPP-së, që obligon AK të analizojë çmimet për të siguruar që nuk janë më të larta se ato të tregut. Në sqarimet e datës 26.11.2025 dhe përgjigjen e datës 01.12.2026, OE ka paraqitur vetëm çmime për artikujt pa shpjeguar formimin e tyre, ndërsa arsyetimet për kosto shtesë nuk qëndrojnë, pasi komisioni i hulumtimit të tregut ka parashikuar të gjitha kostot dhe shpenzimet.

Krahasimi me procedurën tjetër me kohëzgjatje 3-mujore nuk është i saktë, pasi çmimet për të njëjtin artikull ndryshojnë ndjeshëm. Për shembull, për artikullin “Pashtet Pule” OE ka ofruar çmim 1.375 €, ndërsa dëshmia e paraqitur nga vetë OE tregon çmim 0.98 €, pra mbi 40% më i lartë, ndërkohë që vlera e këtij pozicioni është 166,357.00 €.

AK ka të drejtë të kërkojë zbërthimin e çmimeve që konsiderohen më të larta se ato të tregut, bazuar në interpretimin e KRPP-së. Gjithashtu, OE shfrytëzon objektet e AK në Kampin Vrella dhe Kampin Enver Zymberi pa kosto për qira, rrymë, ujë, mbeturina apo sigurim të hapësirave, lehtësira që janë krijuar për të siguruar oferta më të favorshme, jo oferta me çmime të larta si ajo e OE ankues.

Në përfundim, AK nuk ka shkelur asnjë nga nenet e lartcekura, pasi gjatë vlerësimit ka respektuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, dispozitat e LPP dhe legjislacionin sekondar, duke u siguruar që ofertat janë në përputhje me kërkesat dhe me vlerën reale të tregut. Pretendimet ankimore të OE janë të pabazuara. Analiza financiare e bashkëngjitur tregon se, krahasuar me çmimet e planifikuara dhe ato të hulumtimit të tregut, AK do të merrte më pak pako – 132,640.72 pako më pak, që në vlerë financiare përbëjnë 766,823.47 €.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 23.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0168, ndërsa me datë 02.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0168, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është përgjigjur rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Beni Dona Plast SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0168 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK – Policia e Kosovës, ka parashtruar ankesë në OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 62 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues, pas rivlerësimit të ofertave, me datën 27.02.2026 e njofton OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si më poshtë:

Interpretimi nga KRPP si më poshtë:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se AK - Policia e Kosovës e eliminon OE ankues me të njëjtin arsytim, çështje e cila është trajtuar në raportin paraprak të ekspertizës dhe për të njëjtin paneli shqyrtues ka nxjerrë vendimin me Nr. OSHP: 2025/1248 të datës 09/02/2026.

Eksperti shqyrtues sqaron se përgjigjja lidhur me këtë pretendim është dhënë në raportin e ekspertizës Nr. 1248/25, për të cilën vlerëson se është e drejtë e autoritetit kontraktues.

Po ashtu, eksperti shqyrtues sqaron se AK, pas pranimit të vendimit të panelit shqyrtues, e ka formuar komisionin për rivlerësimin e ofertave, të cilët kanë hulumtuar çmimet e tregut. Të gjitha shkresat e lëndës lidhur me rivlerësimin e ofertave dhe hulumtimin e çmimeve nga ana e komisionit rivlerësues janë të bashkëngjitura në raportin e rivlerësimit të AK të publikuar në platformën e E-Prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në ankesën e tij përsëri jep provat e veta, të cilat i konsideron si valide, dhe se çmimet nuk janë më të larta se çmimet e tregut.

Në fund, eksperti shqyrtues, siç e ka vlerësuar edhe në raportin paraprak, sqaron se vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues, bazuar në paragrafin 4 të Nenit 61 të LPP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet pjesërisht ngase edhe pse eksperti e ka arsytuar në këto forme hulumtimin e tregut nga ana e AK -se sipas vendimeve paraprake për këtë procedur me OSHP: 2025/0984 dhe OSHP: 2025/1248 -cituar "... *eksperti shqyrtues,*

sqaron se AK- pas pranimit te vendimit te panelit shqyrtues, e ka formuar komisionin për rivlerësimin e ofertave te cilët kanë hulumtuar çmimet e tregut. Te gjitha shkresat e lendes lidhur me rivlerësimin e ofertave dhe hulumtimin e çmimeve nga ana e komisionit rivlerësues janë të bashkangjitura ne raportin e rivlerësimit te AK të publikuar ne platformën e E-Prokurimit... "

Paneli Shqyrtues nuk e mbeshitet pergjigjen e ekspertit ngase vet AK është në kundërshtim me vendimet /vleresimet e veta krejt kjo kur behet krahasimi i ofertes nga i njejt OE ankues i cili ka përfituar kontrata nga AK-ja sipas procedurave te negociuara pa publikim të Njoftimit për kontrate sikurse parashihet në nenin 35 të LPP-se dhe me kete proceduren e hapur, ku Paneli Shqyrtues për ti vërtetur çmimet e ofruara nga po ky i njëjt OE sipas kontratës së fundit e negociuar dhe për këtë procedur të hapur , konstaton se sa i përket çmimeve për çka është eliminuar artikujt e vendosura nga AK-ja në procedurën e negociuar , mungojnë sikurse në procedurën e hapur si shembull artikujt e pa perfshiera sikurse në procedurën e hapur lajthia, badema, Lugë, thikë, pirun.Paketim alofoli, ku ne disa artikuj ne procedur te negociuar mungon artikulli supa , jogurt çokollad kalorike-proteinike etj. PSH mund ta konsideron qe OE në procedur te hapur ka ofruar çmimet e larta sa i përket artikullit mr 1 (Riste gjedhi) , në çmimin e ofruar prej 9.50 Euro, Pershut pule e tymosur prej 8.47 euro , Pashtet pule në çmimin e ofruar prej 9.50 euro, Pershut viqi në vler prej 8.5 Euro , mirpo Paneli Shqyrtues vëren se tek artikujt Sendviq dhe Bureka , ku artikujt sikurse në këtë procedur dhe të negociuar , dhe nga i njëjt OE tek kontrata me procedurën e negociuar pa publikim të NJK-se ka ofruar çmime më të larta: Sendviq çmimi 3.70 Euro, ndërsa tek Bureku 2.80 Euro, e që për PSH-në është e pa pranushme që AK-ja tek procedura e negociuar ti pranoj çmimet më të larta ku është e kuptueshme që këto artikuj më së shumti mund të shfrytëzohen, ndërsa në procedurën e hapur ti cilëson si çmime të larta në raport me tregun , ku sipas hulumtimit të çmimeve nga AK-ja për pakon 18 Sendviq zbërthimin e çmimit e kane përcaktuar më të lartë për: 16.67 % , ndërsa tek Byrekat : 8 %.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues nga i gjithë elaborimi i kësaj procedure i përshkruar si më lartë ka vendosur të mbetet ne fuqi, B58 Njoftimi mbi vendimin për anulim të aktivitetit te Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS, lidhur me aktivitetin me titull ‘‘Shërbimet me Ushqim (Furnizim, Përgatitje dhe Servim) për nevojat e PK-se’’, me numër të prokurimit 214/30400-25-8322-2-1-1’’,

Paneli Shqyrtues i shqipton vërejtje Autoritetit Kontraktues për shkak të prolongimit të këtij aktivitetit të prokurimit me procedurë të hapur, ndersa në mungesë të kontratave të rregullta, Autoriteti ka vijuar me iniciimin e vazhdueshëm të procedurave emergjente bazuar në Nenin 35 të LPP-së, dhe me veprime të vazhdueshme të cilat cenojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme, andaj kjo vërejtje konsiderohet si vërejtje e fundit duke mare parasysh se procedura e hapur është prolonguar dhe e njejta ka mbetur e pezulluar nga neglizhenca , duke mos ofruar ende një epilog përfundimtar në procedurën e hapur nga mos përgjegjësia e AK-se. Andaj Paneli Shqyrtues bazuar në të lartë cekurat e obligon AK-ne që ti ndërmer veprimet bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së , në mënyr që mos të vije deri te një procedur urgjente sikurse po vazhdon me këtë procedurë dhe mos zbatuar nenin 1, dhe 7 të LPP-së.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më

efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1, lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Beni Dona Plast SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: